



## **Federata e ParaBocciatëKosovës**

Në bazë të statutit të Federata e Para Boccia të Kosovës, Bordi i Federatësë Para Boccia të Kosovës, me datë 22.05.2025 miraton këtë:

### **RREGULLORE E KODIT ETIK TË SPORTIT TË BOCCIAS**

---

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë normat etike për të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet zyrtare të sportit boccia. Kjo përfshin lojtarët, trajnerët, ndihmësit, zyrtarët dhe organizatorët e garave. Zbatimi i etikës garanton integritetin, barazinë dhe respektin në këtë disiplinë paralimpike.

#### **Neni1**

##### **Parimet Themelore të Etikës**

- 1.1 Respekti për kundërshtarin, vetveten dhe zyrtarët e garës.
- 1.2 Barazia në pjesëmarrje, pavarësisht aftësive apo përkatësisë.
- 1.3 Ndershmëria dhe mospranimi i sjelljeve manipuluese.
- 1.4 Respektimi i rregullave të garës dhe vendimeve zyrtare.
- 1.5 Toleranca zero për diskriminim apo ngacmim.

#### **Neni2**

##### **Sjellja e Lojtarëve dhe Asistentëve**

- 2.1 Lojtarët duhet të ruajnë profesionalizëm dhe të shmangin sjelljet provokuese.
- 2.2 Ndalohet përdorimi i gjuhës fyese ose agresive.
- 2.3 Asistentët veprojnë vetëm sipas udhëzimeve të lojtarëve dhe nuk ndërhyjnë në vendimmarrje.
- 2.4 Është e ndaluar ndërhyrja gjatë hedhjes së topave nga lojtarët e tjerë.
- 2.5 Shembuj joetikë: ofendime, vonesa të qëllimshme, simulime të lëndimeve, etj.

**Neni3**  
**Kodi i Sjelljes për Trajnerët dhe Zyrtarët**

- 3.1 Trajnerët duhet të inkurajojnë respektin dhe edukatën sportive.
- 3.2 Zyrtarët të jenë të paanshëm dhe të veprojnë me integritet të plotë.
- 3.3 Ndalohet çdo formë e presionit ndaj zyrtarëve të garës.
- 3.4 Ndhimesa teknike lejohet vetëm në zonat e përcaktuara.
- 3.5 Të shmangët çdo konflikt interesi (p.sh. lidhje familjare me lojtarët në garë).

**Neni4**  
**Sanksionet për Sjellje Joetike**

- 4.1 Paralajmërim verbal
- 4.2 Karton i verdhë: sjellje joetike e lehtë
- 4.3 Karton i kuq: shkelje serioze, përjashtim nga ndeshja
- 4.4 Diskualifikim nga turneu për sjellje të përsëritura ose të rënda
- 4.5 Raportim te autoritetet përkatëse për masa disiplinore shtesë

**Neni 5**  
**Mekanizmat për Ankesa dhe Apelime**

- 5.1 Çdo ankesë për shkelje etike duhet të dorëzohet me shkrim brenda 30 minutave pas përfundimit të ndeshjes.
- 5.2 Komisioni i Garës shqyrton dhe merr vendim brenda ditës.
- 5.3 Pjesëmarrësit kanë të drejtë apelimi tek bordi organizator.
- 5.4 Vendimet e apelimt janë përfundimtare.

**Neni6**  
**Përgjegjësitë e Organizatorëve**

- 6.1 Sigurojnë zbatimin e rregullores së etikës gjatë gjithë garës.
- 6.2 Informojnë paraprakisht të gjitha palët për këtë rregullore.
- 6.3 Sigurojnë ndëshkim të drejtë dhe të barabartë për shkelësit.
- 6.4 Mbajnë dokumentacion për çdo rast të shqyrtuar.

## **Neni 7**

### **Aneks - Shembuj Praktikë të Sjelljes Etike dhe Joetike**

Shembull etik: Një lojtar ndihmon kundërshtarit që ka vështirësi teknike në pajisje.

Shembull joetik: Një trajner bërtet ose ofendon zyrtarët pas një vendimi të diskutueshëm.

Shembull etik: Asistenti qëndron në heshtje gjatë hedhjes së topit, pa ndërhyrje.

Shembull joetik: Simulimi i lëndimit për të fituar kohë ose ndëshkim.

## **Neni 8**

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi Ekzekutiv i FPBOK-së.
2. Çdo rast i pa parashikuar nga kjo rregullore do të trajtohet sipas rregullave të përgjithshme të BISFED dhe vendimeve të FPBOK-së.

Kryetari i FPBOK-së

Murat Murati

---

Prishtinë, 22.05.2025